# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**www.qpz.gov.al**

| **Nr.102** | **3 gusht** | **2010** |
|---|---|---|


PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.512, datë 30.6.2010 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 1, 2, 3, 4, 5 dhe rrugët dytësore, loti 1, 2, 3, nga ana e detit” ...................................................... | 5275 |
| Vendim i KM nr.513, datë 30.6.2010 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv, Tiranë – Podgoricë, qarku Durrës .. | 5280 |
| Vendim i KM nr.518, datë 30.6.2010 | Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë, “Teknologji informacioni” në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë ........................................................................ | 5285 |
| Vendim i KM nr.519, datë 30.6.2010 | Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale .......................... | 5285 |
| Vendim i KM nr.523, datë 30.6.2010 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës .. | 5287 |
| Vendim i KM nr.524, datë 30.6.2010 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Gorë të qarkut të Korçës ........ | 5288 |
| Vendim i KM nr.525, datë 30.6.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.1642, datë 11.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit” ...................................... | 5289 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.526, datë 30.6.2010 | Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Trebinjë të qarkut të Korçës, z. Gjergji Buzo ................................ | 5292 |
| Vendim i KM nr.532, datë 7.7.2010 | Për pjesëmarrje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake, në shtabe të ndryshme në Afganistan ............................................................ | 5292 |
| Vendim i KM nr.533, datë 7.7.2010 | Për një shtesë në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e misionit të Republikës së Shqipërisë pranë selisë së NATO-s, Bruksel", të ndryshuar ................................................................. | 5294 |
| Vendim i KM nr.540, datë 7.7.2010 | Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) ..... | 5294 |
| Vendim i KM nr.541, datë 7.7.2010 | Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kolsh, të qarkut të Kukësit, z. Abedin Uruçi ................................ | 5296 |
| Vendim i KM nr.542, datë 7.7.2010 | Për transferimin e sipërfaqes 116 $m^2$, nga trualli funksional i pronës nr.1047 "Qendër mobilizimi", Berat, në pronësi të bashkisë Berat dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar ................................................ | 5296 |
| Vendim i KM nr.546, datë 7.7.2010 | Për miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie ........................................................................ | 5299 |
| Vendim i KM nr.548, datë 7.7.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.868, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar" ............... | 5300 |
| Vendim i KM nr.550, datë 7.7.2010 | Për dhënie fondi financiar shtesë komunave Qukës e Qendër Librazhd, të qarkut të Elbasanit, për t'u shpërndarë në ndihmë të familjeve të këtyre komunave, për shkak të dëmtimit të banesave të tyre nga fatkeqësi të ndryshme ........ | 5300 |
| Vendim i KM nr.552, datë 7.7.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.1164, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi"........... | 5302 |

## VENDIM
## Nr.512, datë 30.6.2010

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË, LOTI 1, 2, 3, 4, 5 DHE RRUGËT DYTËSORE, LOTI 1, 2, 3, NGA ANA E DETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë arë, truall dhe objekte, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 1, 2, 3, 4, 5 dhe Rrrugët dytësore, loti 1, 2, 3, nga ana e detit".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 31 530 340 (tridhjetë e një milionë e pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e dyzet) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 099 000 (një milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera totale e shpronësimit prej 31 530 340 (tridhjetë e një milionë e pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e dyzet) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 1.8.2010 dhe të përfundojë më 30.10.2010.

7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP", të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronarët e listës së objekteve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Leje ndërtimi" dhe "Vërtetim pronësie", të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin tekniko-ligjor dhe atë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP", në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe atij të pronësisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet "Leje ndërtimi" dhe "Vërtetim hipotekor", në bazë të dokumentacionit të pronësisë, brenda afateve të konfirmuara në pikën 6.

11. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kavajë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

12. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kavajë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin që realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**MPPTT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE**
**DREJTORIA SHPRONËSIMEVE**

# LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS "PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË"
## Loti 1, 2, 3, 4, 5 dhe rrugët dytësore loti 1, 2, 3 nga ana e detit

| Nr. | Pronari | | | Zona kad. | Nr /pas | Sip. $m^2$ | Lloji Pasurisë | Çmimi | Vlera | Loti | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | | | | | | |
| 1 | B/Pronare Morina | | | 8518 | 58/100 | 48 | truall | 20167 | 968016 | Loti 1,2 | Konfirmim nga ZRPP |
| 2 | Ramadan | | Toska | 8518 | 59/33 | 71 | truall | 20167 | 1431857 | Loti 1,2 | Konfirmim nga ZRPP |
| 3 | Beniamin | | Kapllani | 8518 | 59/86 | 393 | truall | 20167 | 7925631 | Loti 1,2 | Konfirmim nga ZRPP |
| 4 | Beniamin | | Kapllani | 8518 | 59/98 | 26 | truall | 20167 | 524342 | Loti 1,2 | Konfirmim nga ZRPP |
| 5 | Galip | | Gjuzi | 2291 | 373/2 | 81 | are | 554 | 44874 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 6 | Ymer | | Lushakaj | 2291 | 373/50 | 78 | are | 554 | 43212 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 7 | Astrit | | Ismaili | 2291 | 373/51 | 42 | are | 554 | 23268 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 8 | Astrit | | Ismaili | 2291 | 373/44 | 10 | are | 554 | 5540 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 9 | Arben | | Burimi | 2291 | 373/48 | 330 | are | 554 | 182820 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 10 | Çlirim | | Beu | 2291 | 373/55 | 58 | are | 554 | 32132 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 11 | B/pr Sabri | | Dedej | 2291 | 373/57 | 226 | are | 554 | 125204 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 12 | Idriz | | Dervishi | 2291 | 104/27 | 573 | are | 554 | 317442 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 13 | Durim | | Dervishi | 2291 | 104/28 | 323 | are | 554 | 178942 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 14 | Hasan | | Sulejmani | 2291 | 104/81 | 260 | truall | 1257 | 326820 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 15 | Agim | | Sula | 2291 | 104/71 | 150 | are | 554 | 83100 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 16 | Agim | | Sula | 2291 | 104/92 | 125 | are | 554 | 69250 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 17 | Ilir | | Rama | 2291 | 104/61 | 55 | are | 554 | 30470 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 18 | Ilir | | Rama | 2291 | 104/58 | 50 | are | 554 | 27700 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 19 | Kostandin | | Risto | 2291 | 104/127 | 300 | truall | 1257 | 377100 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 20 | Nefije | | Bardhi | 2291 | 104/83 | 129 | truall | 1257 | 162153 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 21 | Qerim | | Dervishi | 2291 | 104/64 | 115 | are | 554 | 63710 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 22 | Shyqyri | | Dervishi | 2291 | 104/84 | 23 | are | 554 | 12742 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 23 | Myslym | | Kuka | 2291 | 104/65 | 21 | are | 554 | 11634 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 24 | Vasil | | Papa | 2291 | 104/76 | 8 | are | 554 | 4432 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 25 | Qerim | | Dervishi | 2291 | 104/129 | 10 | are | 554 | 5540 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 26 | Islam | | Lika | 2291 | 104/133 | 58 | are | 554 | 32132 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 27 | Namire | | Gjuzi | 2291 | 104/136 | 18 | are | 554 | 9972 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 28 | Behar | | Male | 2291 | 116/36 | 104 | are | 554 | 57616 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 29 | Tid SHpk B/pronare | | | 2291 | 116/21 | 136 | truall | 1257 | 170952 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 30 | Tid SHpk B/pronare | | | 2291 | 116/38 | 144 | truall | 1257 | 181008 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 31 | Muharrem | | Lutvija | 2291 | 117/34 | 47 | are | 554 | 26038 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 32 | Besim | | Istrefi | 2291 | 117/73 | 19 | are | 554 | 10526 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 33 | Muharrem | | Gjuzi | 2291 | 117/61 | 56 | truall | 1257 | 70392 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 34 | Durim | | Gjuzi | 2291 | 117/58 | 175 | are | 554 | 96950 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 35 | Bashkim | | Koka | 2291 | 117/2 | 85 | are | 554 | 47090 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 36 | Halil | | Koka | 2291 | 117/23 | 73 | are | 554 | 40442 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 37 | Gani | | Koka | 2291 | 117/30 | 265 | are | 554 | 146810 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 38 | B/p Gani | | Hoxha | 2291 | 122/104 | 296 | are | 554 | 163984 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 39 | Agim | | Hoxha | 2291 | 122/88 | 190 | are | 554 | 105260 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 40 | Rifat | | Hoxha | 2291 | 122/76 | 117 | are | 554 | 64818 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 41 | Haxhi | | Estrefi | 2291 | 122/94 | 24 | are | 554 | 13296 | Loti 3 | Konfirmim nga ZRPP |
| 42 | Erbert | | Bodlli | 2291 | 308/113 | 30 | are | 554 | 16620 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 43 | Ndricim | | Bodlli | 2291 | 308/115 | 31 | are | 554 | 17174 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 44 | Zyber | | Bodlli | 2291 | 308/110 | 34 | are | 554 | 18836 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 45 | Isa | | Hoxha | 2291 | 357/101 | 25 | are | 554 | 13850 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 46 | Ilir | | Mecja | 2291 | 357/117 | 40 | are | 554 | 22160 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 47 | Kimete | | Mecja | 2291 | 357/123 | 50 | are | 554 | 27700 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 48 | Arjan | | Sejdani | 2291 | 357/121 | 23 | are | 554 | 12742 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 49 | Ilir | | Mecja | 2291 | 357/119 | 85 | are | 554 | 47090 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 50 | Ahmet | | Habili | 1791 | 71/49 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 51 | Violeta | | Agalliu | 1791 | 71/50 | 27 | are | 340 | 9180 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 52 | Sadullame | | Habili | 1791 | 71/51 | 30 | are | 340 | 10200 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 53 | Artan | | Habili | 1791 | 71/52 | 21 | are | 340 | 7140 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 54 | Batran | | Habili | 1791 | 71/53 | 23 | are | 340 | 7820 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 55 | Lulzim | | Habili | 1791 | 71/54 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 56 | Sulce | | Licaj | 1791 | 89/80 | 247 | are | 340 | 83980 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 57 | B/Pr Halilaj | | | 1791 | 71/55-71-59 | 63 | are | 340 | 21420 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 58 | Ibrahim | | Agalliu | 1791 | 89/18 | 56 | are | 340 | 19040 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 59 | Xheladin | | Dedej | 1791 | 89/73 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 60 | Xheladin | | Dedej | 1791 | 89/76 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 61 | Jonulla | | Estrefi | 1791 | 89/74 | 51 | are | 340 | 17340 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 62 | Sade | | Ducollari | 1791 | 89/77 | 45 | are | 340 | 15300 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 63 | Fatbardh | | Muho | 1791 | 89/79 | 94 | are | 340 | 31960 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 64 | Xhevdet | | Plaku | 1791 | 89/82 | 145 | are | 340 | 49300 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 65 | Dhoksi | | Caci | 1791 | 89/36 | 35 | are | 340 | 11900 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 66 | Fatbardha | | Renja | 1791 | 89/84 | 46 | are | 340 | 15640 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 67 | Fatbardha | | Renja | 1791 | 89/85 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 68 | Hazbi | | Haka | 1791 | 89/87 | 65 | are | 340 | 22100 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 69 | Myzejen | | Plaku | 1791 | 89/81 | 16 | are | 340 | 5440 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 70 | Fiqiri | | Xherri | 1791 | 89/63 | 72 | are | 340 | 24480 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 71 | Resmi | | Kondi | 1791 | 89/64 | 64 | are | 340 | 21760 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 72 | Ali | | Kercova | 1791 | 110/193 | 58 | are | 340 | 19720 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 73 | Ismail | | Kraishta | 1791 | 110/195 | 30 | are | 340 | 10200 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 74 | Teki | | Kala | 1791 | 110/27 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 75 | Ali | | Kalo | 1791 | 110/28 | 44 | are | 340 | 14960 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 76 | Shpresa | | Kala | 1791 | 110/29 | 42 | are | 340 | 14280 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 77 | B/pronare Licaj | | | 1791 | 110/30 | 76 | are | 340 | 25840 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 78 | Sulce | | Licaj | 1791 | 110/31 | 43 | are | 340 | 14620 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 79 | Hekuran | | Selimi | 1791 | 110/32 | 62 | are | 340 | 21080 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 80 | Gentian | | Kamara | 1791 | 110/33 | 59 | are | 340 | 20060 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 81 | Bardhyl | | Karaj | 1791 | 110/34 | 20 | are | 340 | 6800 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 82 | Bardhyl | | Karaj | 1791 | 110/35 | 27 | are | 340 | 9180 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 83 | Sherbet | | Copa | 1791 | 110/36 | 85 | are | 340 | 28900 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 84 | Rrahim | | Alabaku | 1791 | 110/37 | 48 | are | 340 | 16320 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 85 | Qazim | | Alabaku | 1791 | 110/38 | 92 | are | 340 | 31280 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 86 | Ibrahim | | Berisha | 1791 | 110/39 | 63 | are | 340 | 21420 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 87 | Edmond | | Merhori | 1791 | 110/40 | 28 | are | 340 | 9520 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 88 | Zyber | | Dedja | 1791 | 110/41 | 37 | are | 340 | 12580 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 89 | Xheladin | | Metani | 1791 | 110/42 | 34 | are | 340 | 11560 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 90 | Zyber | | Dedja | 1791 | 110/43 | 32 | are | 340 | 10880 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 91 | Xheladin | | Metani | 1791 | 110/44 | 31 | are | 340 | 10540 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 92 | B/pronare Godo | | | 1791 | 110/88 | 118 | are | 340 | 40120 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 93 | Ymer | | Metani | 1791 | 110/49 | 35 | are | 340 | 11900 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 94 | Luan | | Jaho | 1791 | 110/64 | 49 | are | 340 | 16660 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 95 | Faik | | Copani | 1791 | 110/67 | 42 | are | 340 | 14280 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 96 | B/pr Sul | | Hidri | 1791 | 132/73 | 25 | are | 340 | 8500 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 97 | Sulejman | | Hidri | 1791 | 132/78 | 83 | are | 340 | 28220 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 98 | Sul | | Hidri | 1791 | 132/63 | 18 | are | 340 | 6120 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 99 | Mezan | | Arifi | 1791 | 132/66 | 19 | are | 340 | 6460 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 100 | Mezan | | Arifi | 1791 | 132/59 | 125 | are | 340 | 42500 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 101 | Trifon | | Illiu | 1791 | 132/143 | 27 | are | 340 | 9180 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 102 | Bolv Oil SHA | | | 1791 | 132/144 | 86 | are | 340 | 29240 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 103 | Bolv Oil SHA | | | 1791 | 132/79 | 6 | are | 340 | 2040 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 104 | Bolv Oil SHA | | | 1791 | 132/80 | 327 | are | 340 | 111180 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 105 | Vergjeni | | Barko | 1791 | 132/25 | 7 | are | 340 | 2380 | loti 4,6 | Konfirmim nga ZRPP |
| 106 | Sami | | Sheme | 1791 | 132/95 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 107 | Sami | | Sheme | 1791 | 132/40 | 84 | are | 340 | 28560 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 108 | Ilir | | Merhori | 3101 | 90/45 | 50 | truall | 1397 | 69850 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 109 | Ilir | | Merhori | 3101 | 90/8 | 13 | are | 336 | 4368 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 110 | Besnik | | Hasa | 3101 | 90/9 | 63 | are | 336 | 21168 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 111 | Zamake | | Hasa | 3101 | 90/12 | 71 | are | 336 | 23856 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 112 | Shpetim | | Gjuzi | 3101 | 90/42 | 76 | are | 336 | 25536 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 113 | Bore | | Vila | 3101 | 90/14 | 55 | are | 336 | 18480 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| 114 | Rifat | | Hasa | 3101 | 90/10 | 63 | are | 336 | 21168 | loti 4,5 | Konfirmim nga ZRPP |
| | **SHUMA** | | | | | **9429** | | | **15734535** | | |

TABELA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PËR SEGMENTIN
BY PASS PLEPA KAVAJË – RROGOZHINË, LOTI 1, 2, 3, 4, 5 DHE RRUGËT DYTËSORE, LOTI 1, 2, 3 NGA ANA E DETIT

| Nr. | Objekti | Pronari | Vlera (lek) | Shënime |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Karburant Eurodrin (shesh+lulishte) | Xhaferr & Agim Kraja | 1991508 | Leje Ndertimi |
| 2 | Karburant Alpet 1 (shesh+lulishte) | Mustafa Koka | 1855072 | Vertetim Hipotekor |
| 3 | Karburant Alpet 2 (shesh+lulishte) | K.Risto, A.Dimo | 984474 | Leje Ndertimi |
| 4 | Karburant Klevi (shesh+lulishte) | Gramoz Manaj | 1090300 | Leje Ndertimi |
| 5 | Hotel Skampa (shesh+parkim) | Agim Sula | 3002120 | Leje Ndertimi |
| 6 | Karburant ne ndertim (shesh) | Besnik Hasa | 616502 | Leje Ndertimi |
| 7 | Shesh | Agim Shala | 396575 | Leje Ndertimi |
| 8 | Shesh | Iliaz Dervishi | 394550 | Leje Ndertimi |
| 10 | Magazine+zyra | Xhevahir Topalli | 3350452 | Konfirmim nga ZRPP |
| 11 | Magazine+zyra | Shpetim Bizhdili | 2114251 | Leje Ndertimi |
| | **SHUMA** | | **15795805** | |

# VENDIM
# Nr.513, datë 30.6.2010

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV, TIRANË–PODGORICË, QARKU DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 KV, Tiranë–Podgoricë, qarku Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST, sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1843.7 (një mijë e tetëqind e dyzet e tre pikë shtatë) m², tokë bujqësore arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 620 960 (gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Fondi prej 620 960 (gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 895 000 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohet nga OST sh.a., si subjekt që garanton shpenzimet procedurale të këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit korrik 2010 dhe të përfundojë brenda muajit tetor 2010.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik".

8. Punimet për ndërtimin e linjës 400 KV Tiranë – Podgoricë, qarku Durrës, të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2010.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS "400 KV, ZONA E QARKUT DURRËS"
TABELA PËRMBLEDHËSE PËR QARKUN DURRËS

| Nr. | Objekti | Shpronësimi definitiv | | | | | | | | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. kadastral | Nr. i pasurisë | Sasia e sip. pronës $m^2$ | Sipërfaqe shtylla për shpronësim defenitiv $m^2$ | Çmimi i tokës lek/$m^2$ | Vlera e kompensimit | |
| | **Rrethi Krujë** | | | | | | | | | | | |
| | Bashkia Krujë (shtylla 249-259) | | | | | | | | 232.3 | | 57,615 | |
| | Komuna Thumanë (shtylla 260-263) | | | | | | | | 418.6 | | 151,957 | |
| | Bashkia Fushë Krujë (shtylla 264-278) | | | | | | | | 958.3 | | 1,874,995 | |
| | Komuna Nikël (shtylla 279-283) | | | | | | | | 395.7 | | 72,413 | |
| | **Shuma** | | | | | | | | **2,004.9** | | **2,084,566,5** | |
| | **Qarku Durrës** | | | | | | | | **1,843.7** | | **620,960.1** | |

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS "400 KV, ZONA E QARKUT DURRËS"

Qarku: Durrës
Rrethi: Krujë
Komuna: Nikël

| Nr. | Nr. i shtyllës | Pronësia | | | | | | | | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. kadastral | Nr. i pasurisë | Sasia e sip. pronës $m^2$ | Shtylla sipërfaqe definitive $m^2$ | Çmimi i tokës lek/$m^2$ | Vlera e kompensimit | |
| | **Komuna Nikël** | | | | | | | | | | | |
| | Verjon | | | | | | | | | | | |
| | 279 | Komuna Nikël | | | Pyll | 3783 | 5 | | 98.9 | | | Shtet |
| | 280 | Komuna Nikël | | | Pyll | 3783 | 11 | | 87.1 | | | Shtet |
| | 281 | Hamdi | Asllan | Doku | Pyll | 3783 | 36/2 | | 130.9 | 191 | 24,999 | S'ka informacion |
| A6b | 282 | Korb | Abaz | Brata | Arë | 3783 | 241/5 | | 165.9 | 191 | 31,686 | S'ka informacion |
| | Kurcaj | | | | | | | | | | | Konfirmuar ZVRPP |
| | 283 | Idriz | Isuf | Milla | | 2333 | 897/11 | | 98.9 | 159 | 15,728 | Konfirmuar ZVRPP |

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS “400 KV, ZONA E QARKUT DURRËS”

Qarku: Durrës
Rrethi: Krujë
Komuna: Thumanë

| Nr. | Nr. i shtyllës | Pronësia | | | | | | | | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. kadastral | Nr. i pasurisë | Sasia e sip. pronës $m^2$ | Shtylla sipërfaqe definitive $m^2$ | Çmimi i tokës lek/$m^2$ | Vlera e kompensimit | |
| | **Komuna Thumanë** | | | | | | | | | | | |
| | Borizanë | | | | | | | | | | | |
| | 261 | Besim Selman Ramazan | | Leka | ullishte | K-34-88-(120-B) | | | 111.5 | 363.0 | 40.489 | Nuk është në sistem |
| | 262 | Sejfulla Hasan Shefqet | | Leka | ullishte | K-34-88-(120-B) | | | 109.8 | 363.0 | 39.872 | Nuk është në sistem |
| | 263 | Fisi Kola | | | ullishte | K-34-88-(120-B) | | | 197.2 | 363.0 | 71.596 | Nuk është në sistem |

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS “400 KV, ZONA E QARKUT DURRËS”

Qarku: Durrës
Bashkia: Krujë

| Nr. | Nr. i shtyllës | Pronësia | | | | | | | | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Emri** | **Atësia** | **Mbiemri** | **Lloji i pasurisë** | **Nr. kadastral** | **Nr. i pasurisë** | **Sasia e sip. pronës $m^2$** | **Shtylla sipërfaqe definitive $m^2$** | **Çmimi i tokës lek/$m^2$** | **Vlera e kompensimit** | |
| | **Bashkia Krujë** | | | | | | | | | | | |
| | Picraga | | | | | | | | | | | |
| | 256 | Murat | | Hima | pemëtore | 3957 | 622 | | 109.8 | 248 | 27,240 | S’ka informacion |
| | 257 | Pretendim pronësie | | | pemëtore | 3957 | 725 | | 122.5 | 248 | 30,375 | S’ka informacion |

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS “400 KV, ZONA E QARKUT DURRËS”

Qarku: Durrës
Rrethi Krujë

| **Nr.** | **Nr. i shtyllës** | **Pronësia** | | | | | | | | | | **Shënime** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Emri** | **Atësia** | **Mbiemri** | **Lloji i pasurisë** | **Nr. kadastral** | **Nr. i pasurisë** | **Sasia e sip. pronës $m^2$** | **Shtylla banesë sipërfaqe defenitive $m^2$** | **Çmimi i tokës, banesës lek/$m^2$** | **Vlera e kompensimit** | |
| | **Bashkia Fushë-Krujë** | | | | | | | | | | | |
| **Fushë-Krujë Fshat** | | | | | | | | | | | | |
| | 266c | Fatmir | | Zalla | Arë | 1665 | 91/2 | | 212.9 | 451.0 | 96.030 | Certifikatë |
| | 266d | Hasan | | Zalla | Arë | 1665 | 114/32 | | 111.5 | 451.0 | 50.304 | Konfirmuar ZVRPP |
| A7b | 267 | | | | | 1665 | 114/21,115 | | 124.7 | | | Shtet |
| Halil | | | | | | | | | | | | |
| | 268 | Hysen(Hysni) | | Sala | Ullishtë | 1921 | 298/28 | | 111.5 | 274.0 | 30.562 | Konfirmuar ZVRPP |
| | 269 | Drita | | Dervishi | Ullishtë | 1921 | 307/3 | | 111.5 | 274.0 | 30.562 | Konfirmuar ZVRPP |
| | Banesë nën linjë | Lulzim | | Koni | Banesë | | | | 30.4 | 52,230.0 | 1,586.225 | Proces legalizimi |
| | 270 | Sulejman | Halit | Boga | Ullishtë | 1921 | 314/3 | | 98.9 | 274.0 | 27.104 | Konfirmuar ZVRPP |
| | 271 | Hasan | | Rama | Ullishtë | 1921 | 324/4 | | 98.9 | 274.0 | 27.104 | Konfirmuar ZVRPP |
| | 276 | Haxhi | | Bazja | pemëtore | 1921 | 384 | | 98.9 | 274.0 | 27.104 | S’ka informacion |
| | | | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr.518, datë 30.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, "TEKNOLOGJI INFORMACIONI", NË UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI", KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Fan S. Noli", Korçë, të programit të studimeve të ciklit të parë "Teknologji informacioni".
2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP) në "Teknologji informacioni".
3. Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike.
4. Programi studimeve "Teknologji informacioni" të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit "Fan S. Noli", Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Fan S. Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.519, datë 30.6.2010**

**PËR PROCEDURAT E PROPOZIMIT E TË MIRATIMIT DHE RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË PARQEVE NATYRORE RAJONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11/1 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Park natyror rajonal shpallen sipërfaqet, pronë publike, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) ndodhen brenda territorit administrativ të qarkut;

b) janë jo më të vogla se 50 ha;

c) sigurojnë mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror e të biodiversitetit në shkallë lokale;

ç) janë zona të gjelbra natyrore, ose të kultivuara, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike tradicionale, duke respektuar kërkesat e parimit të përdorimit të qëndrueshëm të territorit;

d) janë të populluara me lloje të florës dhe faunës kryesisht të karakterit lokal;

dh) ofrojnë mundësi për komunitetin të ushtrojë veprimtari shoqërore, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, rekreative dhe turistike;

e) nuk janë të përfshira në rrjetin ekzistues të zonave të mbrojtura;

ë) nuk janë habitate të llojeve të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla dhe endemike, të cilat mbrohen në nivel kombëtar me një akt të veçantë normativ.

2. Parqet natyrore rajonale krijohen në nivel bashkie, komune dhe qarku. Për të propozuar miratimin e tyre, komunat, bashkitë ose qarqet ndjekin këtë procedurë:

a) Fillimisht hartohet propozimi për shpalljen e parkut, ku përcaktohen sipërfaqja që synohet të shpallet park, kufijtë dhe shkalla e ruajtjes së tij.

b) Propozimi hartohet, sipas rastit, nga strukturat përkatëse të komunës, bashkisë ose qarkut, në bashkëpunim me organet shtetërore vendore të interesuara, me institucionet kërkimore-shkencore vendore, me drejtorinë rajonale të shërbimit pyjor dhe me shoqatat mjedisore vendore. Kur propozimin e bëjnë komunat ose bashkitë, marrin edhe miratimin paraprak të këshillave të tyre. Kur propozimin e bën këshilli i qarkut, merr edhe mendimin paraprak të komunave e bashkive, në territorin e të cilave do të shtrihet parku.

c) Propozimi hartohet në përputhje me strategjitë sektoriale të veprimtarive që parashikohet të zhvillohen, planet e veprimit e programet e zhvillimit të qarkut dhe kërkesat e strategjisë e të planit të veprimit për biodiversitetin.

ç) Propozimi publikohet për një afat dymujor, brenda të cilit komuniteti dhe bizneset e zonës bëjnë vërejtje e sugjerime, të cilat i paraqiten këshillit të qarkut.

3. Propozimi shoqërohet me studimin përkatës, në të cilin përfshihen:

a) argumentimi për krijimin e parkut natyror rajonal, nevoja e krijimit dhe përfitimet e përdorimit;

b) rezultatet e procesit të këshillimit me komunitetin e grupet e interesuara, duke përfshirë komentet e bëra dhe reflektimin e propozimeve;

c) përshkrimi fizik i sipërfaqes së propozuar;

ç) përshkrimi i masave dhe investimeve që do të bëhen për mirëmbajtjen e parkut;

d) kufijtë dhe zonimi i brendshëm dhe ai i zonës buferike me shkallët e mbrojtjes, të propozuar për secilën nënzonë përdorimi. Ndarja e sipërfaqes së parkut natyror rajonal në nënzona përdorimi bazohet në rëndësinë e habitateve, ekosistemeve, llojeve floristike e faunistike, vlerave historike, kulturore, arkeologjike-monumentale dhe ekoturistike rajonale;

dh) harta dixhitale e zonës;

e) administrata e ruajtjes dhe menaxhimit të parkut.

4. Shpallja e parkut natyror rajonal bëhet me vendim të këshillit të qarkut. Vendimi shpallet në shtyp dhe në mediat lokale, si dhe në faqen e internetit të qarkut, në të cilën paraqiten:

a) vendimi i shpalljes së parkut natyror rajonal;

b) propozimi i miratimit;

c) studimi përkatës;

ç) hartat me nënzonat e kufijtë;

d) plani i menaxhimit;

dh) rregullorja e parku;

e) administrata e ruajtjes dhe e menaxhimit.

5. Administrimi i parqeve natyrore rajonale kryhet sipas këtyre rregullave:

a) Parku natyror rajonal ruhet dhe menaxhohet nga administrata e tij.

b) Pas miratimit të parkut natyror rajonal, administrata e tij vendos shenjat treguese në terren, sipas kufijve të miratuar, dhe bën hedhjen në skedarin e zonës së mbrojtur.

c) Në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të shërbimit pyjor dhe organet e tjera shtetërore vendore, OJF-të mjedisore dhe komunitetin e biznesit, struktura përkatëse e qarkut harton planin e menaxhimit të parkut natyror rajonal, konform procedurave të përcaktuara në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, për të cilin merret edhe mendimi i ministrive të linjës. Plani i menaxhimit miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,

ç) Plani i menaxhimit dhe planet e veprimit të parkut natyror rajonal zbatohen nga administrata e parkut, në bashkëpunim me specialistët e drejtorisë rajonale të shërbimit pyjor.

d) Brenda 3 (tri) muajve nga shpallja e parkut natyror, administrata e tij harton rregulloren e funksionimit të parkut, e cila miratohet nga këshilli i qarkut.

6. Këshilli i qarkut ia dërgon një kopje të vendimit për shpalljen e parkut natyror rajonal, së bashku me studimin dhe hartat dixhitale, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si organ i ngarkuar, nga dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura", për administrimin, shënimin e tyre në skedarin kombëtar të rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura dhe për raportime në organizmat përkatës shtetërorë e ndërkombëtarë.

7. Strukturat inspektuese të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ushtrojnë kontrolle në parqet natyrore rajonale.

8. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.523, datë 30.6.2010

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MARTANESH, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Martanesh të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 804 (tetëqind e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Martanesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Martanesh Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-3,6,8,9,11,12,16,301-303,305-309,311-313,318, 320-327,376,377,379,380,382-385,387 392,394-404,406,408,410-415,448-450,513,514, 522,523,535-540,550-552,636,637,639,644-647,653,655,660,663,664,667,670,671. | Pyje dhe kullota | Në pronësi |
| 673-674 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 675-681 | Varreza publike | Në pronësi |
| 682-689 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 690-695 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik. | Në pronësi |
| 696-698,702,703,707-710,712,713,715,716,719,720 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 699,700,701,704,705,706,711,714,717,718,721,722 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta) | Në përdorim |
| 728-738 | Infrastrukturë (rrugë vendore) | Në pronësi |
| 739 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.524, datë 30.6.2010**

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GORË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Gorë të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Gorë                                                                 Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 112-130 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 106-111 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 70-98 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 44-69 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 99-105 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 692-707,709-743 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 645-647,649,650,652,653,655,656, 658,659,661,663,664,667,668,670, 671,673,674,676,677,679,680,682, 683,685,686,688,689 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 648,651,654,657,660,662,665,666, 669,672,675,678,681,684,687 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive) | Në pronësi |
| 746-756 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve | Në pronësi |
| 1-36 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile. | Në pronësi |

## VENDIM
## Nr.525, datë 30.6.2010

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1642, DATË 11.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit, të miratuar me vendimin nr.1642, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1 dhe formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Përrenjasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 871-875 | Prona që përdoren në fushën e ujësjellësit | Në pronësi |
| 876-882 | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |

## LISTA E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
## PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA

| Bashkia: Përrenjas<br>Fusha e përdorimit: | Identifikoi: Mislim Hana specialist topograf<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)<br>Supervizori: Eqerem Karriqi, P/urbanistikës<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)<br>Aprovoi: Artur Topi, kryetar i bashkisë, 05912404<br>(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula) |
|---|---|

| | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastr. dhe indeksi i hartës** | **Nr. pasurie** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës, adresa** | **Sip. totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sipërfaqja totale sa ndërtesë ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Institucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 871 | | | Ndërtesë | Depo uji 1000 $m^3$ bashkia Përrenjas | 375 | 375 | Furnizim me ujë të pijshëm | Bashkia Përrenjas | Bashkia Përrenjas | |
| 872 | | | Ndërtesë | Stacioni i pomëps Bitumi bashkia Përrenjas | 88 | 88 | Sistem ujitës | Bashkia Përrenjas | Bashkia Përrenjas | Jashtë funksioni |
| 873 | | | Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm | | 4958 ml | | Furnizim me ujë të pijshëm | Bashkia Përrenjas | Bashkia Prrenjas | |
| 874 | | | Sistemi i shpërndarjes së qytetit | | 6870 ml | | Furnizim me ujë të pijshëm | Bashkia Përrenjas | Bashkia Prrenjas | |
| 875 | | | Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza & bardha | | 4600 ml | | | Bashkia Përrenjas | Bashkia Prrenjas | |
| 876 | | 4/14 | Ndërtesë | Ish-mensa dhe kuzhina në stacionin hekurudhor Përrenjas | 240 | 160 | Jashtë funksioni | Sh.a Hekurudha Durrës | Sh.a Hekurudha Durrës | Adaptuar banesë |
| 877 | | | Ndërtesë | Ish peshore pranë bitumit | 260 | 112 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |
| 878 | | | Ndërtesë | Ish-peshore Min.Kromit | 150 | 65 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |
| 879 | | 3/55 | Ndërtesë | Ish-peshore Min.hekurit | 600 | 120 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |
| 880 | | 3/49 | Ndërtesë | Ish-magazinë | 1200 | 817 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |
| 881 | | 3/56 | Ndërtesë | Ish-magazinë | 800 | 428 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |
| 882 | | 3/57 | Ndërtesë | Ish-magazinë | 1200 | 464 | Jashtë funksioni | Min. Ekonomisë | B. Përrenjas | Adaptuar banesë |

## VENDIM
## Nr.526, datë 30.6.2010

## PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS TREBINJË TË QARKUT TË KORÇËS, Z. GJERGJI BUZO

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës dhe të shkronjës "a" të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda të ligjit, të kryetarit të komunës Trebinjë të qarkut të Korçës, z. Gjergji Buzo.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.532, datë 7.7.2010

## PËR PJESËMARRJE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË NDRYSHME NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë të marrin pjesë në këto misione ushtarake, në Afganistan:

1.1 Në Shtabin ISAF (Shtabi i Bashkuar Operacional dhe Shtabi Qendror), Kabul, Afganistan.

- Misioni: Planëzimi, monitorimi dhe kontrolli i veprimtarisë operacionale të njësive të ISAF-it.
- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.
- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.
- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani/Itali-Afganistan është përgjegjësi e NATO-s, ndërsa Shqipëri-Gjermani/Itali dhe anasjelltas është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.2 Në Shtabin NTM-A (NATO Training Mission-Afghanistan)

- Misioni: Edukimi dhe trajnimi i personelit të Forcave të Ushtrisë Afgane (ANA), pranë Komandës Afgane.
- Numri i pjesëmarrësve, 5 (pesë) ushtarakë.
- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, 4 (katër) ushtarakë në Kabul dhe 1 (një) ushtarak në Herat, Afganistan.

1.3 Në Shtabin PRT (Provincial Reconstruction Team)

- Misioni: Kontribut në rindërtimin e institucioneve dhe organizmave të sigurisë në Afganistan.

- Numri i pjesëmarrësve, 2 (dy) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Pole-Khomri, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Hungari-Afganistan është përgjegjësi e palës hungareze, ndërsa Shqipëri-Hungari dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.4 Në Komandën Rajonale të Veriut "ISAF" (ISAF RC North)

- Misioni: Oficer shtabi për hartimin dhe ndjekjen e procedurave standarde në Shtabin e ISAF-it, në veri të Afganistanit.

- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Mazar-E-Sharif, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e NATO-s, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.5 Në "ENDURING FREEDOM" Komanda e Koalicionit për Transferim dhe Siguri (CSTC-A).

- Misioni: Kontribut për transferimin dhe sigurinë e personelit të Forcave të Ushtrisë Afgane (ANA), pranë Komandës Afgane.

- Numri i pjesëmarrësve, 4 (katër) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi në Kabul, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e palës amerikane, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.6 Në ekipet e këshillimit dhe trajnimit (OMLT).

- Misioni: Këshillim dhe trajnim i personelit të shtabit të Brigadës së Parë, të Komandës Rajonale të Veriut (korpusi 209), e dislokuar në veri (Mazar-El-Sharif) të ushtrisë afgane.

- Numri i pjesëmarrësve, 1 (një) ushtarake.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Mazar-E-Sharif, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e palës gjermane, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

2. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këto operacione, shpenzimet për:

- shpërblimin që do të marrin këta ushtarakë për vështirësi shërbimi, në masën 9000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

- siguracion jete;

- mbivendosje;

- shpenzime telefonike;

- shërbime postare;

- shpenzime telefonike emergjente;

- evakuim mjekësor;

- trajtim mjekësor;

- çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë sipas tabelës bashkëlidhur dhe përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.533, datë 7.7.2010

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË SELISË SË NATO-S, BRUKSEL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 2/1, te përbërja e përfaqësisë ushtarake, të shtohet emërtesa:

"- Oficer ndërlidhës i SHIU-t, nënkolonel – kolonel;".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.540, datë 7.7.2010

## PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATIT, PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË, SI VEND ZBATUES, NË NISMËN PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE (EITI)

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 1, e 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e sekretariatit për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

2. Sekretariati e ka selinë në Tiranë dhe e zhvillon veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Sekretariati është institucion në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ka vulën e logon e tij.

4. Misioni i sekretariatit është realizimi i të gjithë hapave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), dhe, pas këtij anëtarësimi, përgatitja e raporteve vjetore, si vend zbatues i kësaj Nisme, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

5. Detyrat dhe objektivat e sekretariatit janë:

a) Ngritja dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve, të miratuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

b) Rishikimi i bazës ligjore për të evidentuar pengesat e mundshme për zbatimin e EITI-së;

c) Ndërtimi i kapaciteteve/trajnimi i punonjësve shtetërore, i shoqërisë civile ( përfshirë dhe median), i grupeve të interesit për EITI-në dhe problemet në sektorin e industrisë nxjerrëse;

ç) Hartimi i raporteve vjetore dhe i raportit të vlerësimit, auditimit të raportit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të vlerësimit, si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

d) Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit për zbatimin e EITI-së dhe monitorimi i tyre;

dh) Publikimi dhe shpërndarja e raporteve në përputhje me kërkesat e EITI-së;

e) Hartimi në vazhdimësi i raporteve vjetore dhe garantimi i auditimit të tyre;

ë) Përzgjedhja dhe sigurimi i përgatitjes profesionale të personelit të nevojshëm, në mbështetje të programit të veprimit të EITI-së, në fazat e ndryshme të saj;

f) Raportimi para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit dhe të hapave të anëtarësimit.

6. Sekretariati, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, do të bashkëpunojë dhe do të bashkërendojë veprimtarinë e tij me grupin ndërinstitucional të punës së Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe me institucione të tjera, publike dhe/ose private, me grupet e interesit, shoqërinë civile, median vendase dhe/ose të huaj.

7. Sekretariati është institucion buxhetor që financohet nga:

a) buxheti i shtetit (fonde të destinuara për programin e veprimeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse , EITI);

b) burime financiare nga palë të treta, të destinuara për programin e veprimeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse EITI, nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2010, fondet e përcaktuara në buxhetin e shtetit për institucionin e AKBN-së, për problematikat e EITI-së, do të përdoren nga ky sekretariat.

8. Sekretariati e përdor buxhetin për fondin e pagave të punonjësve dhe për shpenzime të tjera, në funksion të përmbushjes së misionit dhe të detyrave të tij.

9. Drejtuesi i sekretariatit emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit.

10. Drejtuesi i sekretariatit përfaqëson sekretariatin në marrëdhënie me të tretët.

11. Funksionimi i sekretariatit bazohet në rregulloren e funksionimit, e cila hartohet nga strukturat e tij dhe miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

12. Sekretariati raporton në çdo mbledhje të grupit ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe çdo vit, në mënyrë periodike, përgatit informacion me shkrim për Kryeministrin për ecurinë e realizimit të programit të veprimeve dhe të raportit vjetor të EITI-së.

13. Procedurat e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të sekretariatit bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe me aktet nënligjore në fuqi.

14. Brenda një periudhe tremujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sekretariati duhet të plotësohet me numrin e duhur të punonjësve.

15. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të siguruar mjediset e punës për punonjësit e sekretariatit.

16. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**
5295

**VENDIM**
**Nr.541, datë 7.7.2010**

**PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS KOLSH TË QARKUT TË KUKËSIT, Z. ABEDIN URUÇI**

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës dhe të shkronjës "a" të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin e z. Abedin Uruçi nga detyra e kryetarit të komunës Kolsh, të qarkut të Kukësit, për shkelje të rënda të ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.542, datë 7.7.2010**

**PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 116 M$^2$, NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.1047 "QENDËR MOBILIZIMI", BERAT, NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e sipërfaqes 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m$^2$ dhe gjatësi 38.6 (tridhjetë e tetë pikë gjashtë) ml, nga trualli funksional i pronës nr.1047 "Qendër mobilizimi" në Berat, e cila ndodhet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, në pronësi të bashkisë Berat, sipas genplanit bashkëlidhur, për ta përdorur për nevoja urbanistike (rrugë publike).
2. Në listën e pronave bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) m$^2$ nga trualli funksional i pronës nr.1047 "Qendër mobilizimi" në Berat.
3. Bashkisë Berat i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqes të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Bashkia Berat të rindërtojë murin rrethues, që do të prishet, brenda një muaji nga dorëzimi i sipërfaqes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë dorëzimin për kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje bashkisë Berat, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia Berat për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme për transferimin e kësaj sipërfaqeje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Për inventarizimin e pronave të veçanta)

| **Bashkia Berat** | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| **Nr.** | **Zona kadast.Indeksi i hartës** | **Numri i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emërtimi i pronës adresa** | **Sipërfaqe totale pronës në $m^2$** | **Nga sipërf.totale sa ndërtime në $m^2$** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Enti me përgjegjësi administrative** | **Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera shënime të veçanta** |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 047 | | | | Qendra e mobilizimit Berat, lagjja "30 vjetori" | 1468 $m^2$ | 468 $m^2$ | Për mbrojtjen | MM Qendra e mobilizimit Berat | Qendra e mobilizimit Berat | |
| | | | | Godina e QM | 268 | 268 | | | | 3 kate |
| | | | | Truprojë klasa | 200 | 200 | | | | |
| | | | | Truall | 1000 | - | | | | |


qendra e rekrutim
mobilizim te ushtrise

**VENDIM**
**Nr.546, datë 7.7.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 3, dhe të pikës 1, të nenit 33 të ligjit nr.10253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Shtojcë

LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

| **Nr.** | **Emri shkencor i llojit** | **Emri shqip** |
|---|---|---|
| 1 | Lepus europaeus | Lepur i egër |
| 2 | Vulpes vulpes | Dhelpër |
| 3 | Anas penelope | Kryekuqe e madhe |
| 4 | Anas platyrhynchos | Kuqja |
| 5 | Anas crecca | Grilla |
| 6 | Anas strepera | Rosa e zezë |
| 7 | Anas acuta | Bishtëgjela |
| 8 | Anas clypeata | Sqepluga |
| 9 | Anas querquedula | Marsatorja |
| 10 | Gallinago gallinago | Shapkë uji |
| 11 | Fulica atra | Bajza |
| 12 | Alectoris graeca | Thëllëzë mali |
| 13 | Columba livia | Pëllumb i egër |
| 14 | Scolopax rusticola | Shapka |
| 15 | Streptopelia turtur | Turtulli |
| 16 | Coturnix coturnix | Shkurta |
| 17 | Alauda arvensis | Lauresha |

**VENDIM**
**Nr.548, datë 7.7.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.868, DATË 12.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.868, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë si vijon:

"2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Struktura dhe organika e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.550, datë 7.7.2010**

**PËR DHËNIE FONDI FINANCIAR SHTESË KOMUNAVE QUKËS E QENDËR LIBRAZHD, TË QARKUT TË ELBASANIT, PËR T'U SHPËRNDARË NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË KËTYRE KOMUNAVE, PËR SHKAK TË DËMTIMIT TË BANESAVE TË TYRE NGA FATKEQËSI TË NDRYSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010" dhe të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunave Qukës e Qendër Librazhd të qarkut të Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t'u jepet fond financiar shtesë, për t'u shpërndarë në ndihmë të familjeve të këtyre komunave, për shkak të dëmtimit të banesave të tyre nga fatkeqësi të ndryshme, si më poshtë vijon:

a) Komunës Qukës, 10 900 000 (dhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

b) Komunës Qendër Librazhd, 7 700 000 (shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekë.

2. Fondet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij vendimi, t'u shpërndahen familjeve sipas listës me emrat e kryefamiljarëve, të hartuar për secilën komunë, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Fondi i përgjithshëm, 18 600 000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut të Elbasanit, këshilli i qarkut të Elbasanit dhe komunat Qukës e Qendër Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTAT ME EMRAT E KRYEFAMILJARËVE, PËR SECILËN KOMUNË TË QARKUT ELBASAN, TË CILËT PËRFITOJNË NDIHMË FINANCIARE, SIPAS KËTIJ VENDIMI

Komuna Qukës

| Nr | Emër, atësi, mbiemër | Ndihma 000/lekë |
|---|---|---|
| 1 | Liman Muharrem Dashballa | 1100 |
| 2 | Shahe Nuredin Dashballa | 1100 |
| 3 | Ilia Hekuran Dashballa | 1000 |
| 4 | Vasil Shaban Zharri | 1200 |
| 5 | Pandeli Shaban Zharri | 1000 |
| 6 | Lushe Isuf Zharri | 600 |
| 7 | Hajdar Sejfulla Radiçi | 500 |
| 8 | Isa Xhaferr Belba | 300 |
| 9 | Xhevdet Ferik Belba | 1100 |
| 10 | Luze Qazim Omeri | 600 |
| 11 | Makbule Dule Zeneli | 600 |
| 12 | Avni Halil Polisi | 600 |
| 13 | Bajame Hysen Pjetri | 700 |
| 14 | Aqif Nazmi Liçi | 500 |
| | **Shuma** | **10900** |

Komuna Qendër Librazhd

| Nr | Emër, atësi, mbiemër | Ndihma 000/lekë |
|---|---|---|
| 1 | Agim Koka | 1100 |
| 2 | Limon Alla | 700 |
| 3 | Hasan Alla | 1000 |
| 4 | Petrit Alla | 1000 |
| 5 | Viktor Alla | 700 |
| 6 | Fatmir Dosku | 700 |
| 7 | Rasim Alla | 800 |
| 8 | Naim Alla | 800 |
| 9 | Agron Dosku | 900 |
| | **Shuma** | **7700** |

**VENDIM**
**Nr.552, datë 7.7.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1164, DATË 25.11.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr.1164, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Kuota e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, për vitin 2009-2010, është 77 dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) Në "Shkencat gjuhësore" 15 kuota;
b) Në "Studime letrare" 20 kuota;
c) Në "Shkencat etnologjike dhe folklor" 10 kuota;
ç) Në "Shkencat historike" 22 kuota;
d) Në "Shkencat arkeologjike" 10 kuota.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL ........................................................................ 226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.................................................. 330 lekë
KUSHTETUTA ........................................................................ 95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE 140 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2010
Doli nga shtypi më 3.8.2010

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 2300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë